



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LEZHË

Nr.76( 61004-00470-53-2019) Regj. Themeltar  
Data e regj. 20.03.2019.

Nr 76 Vendimit  
Datë 21.03.2019.

**VENDIM**

**“PËR HEQJEN E MASËS SË SIGURIMIT PASUROR”**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë e përbërë prej

**GJYQTAR - ARTAN HAJREDINAJ**



Asistuar nga sekretare Diella Ndoci, sot në datë 21.03.2019, në Lezhë, shqyrtoi në seancë gjyqësore çështjen penale me Nr. 76 Akti që i përket:

**KËRKUES:**

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë, përfaqësuar nga prokuror Erjon Shehaj.

**OBJEKT:**

Heqjen e sekuestros preventive te vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhe me vendimin nr 17, dt 23.01.2019, mbi llogarine bankare me nr \_\_\_\_\_, prane bankes BKT, ne te cilen kalon paga çdo muaj per shtetasen S! P: .

**BAZA LIGJORE:**

Neni 274/3 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata, në përfundim të gjykimit të zhvilluar, pas administrimit të provave, në prani të prokurorit, i cili kërkoi sipas objektit, si dhe pasi shqyrtoi aktet dhe çështjen në tërësi, e analizoi kushtet për heqjen e masës së sigurimit pasuror, heqjen e sekuestros preventive;

**VEREN SE:**

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë mbi bazën e kallëzimit penal te referuar nga Drejtoria Vendore e Policise Lezhe, me shkresen nr. 49 prot, date 22.01.2019, ne date 22.01.2019 ka rregjistruar procedimin penal nr. 57 viti 2019 per vepren penale te “Pastrimi i produkteve te vepres penale” te parashikuar nga neni 287 te K.Penal.

Pas shqyrtimit te kerkeses, Gjykatata e rrethit gjyqësor Lezhe me vendimin Nr. 17 date 23.01.2019 ka pranuar kerkesen e prokurorise sipas objektit. Gjykatat ne vendimin Nr. 17 date 23.01.2019 ka arsyetuar se;





kaufizimit të së drejtës së pronës të përcaktuara nga jurisprudenca e GJEDNJ. monetare me qëllim mosrëndimin e pasojave të veprës penale, duke plotësuar kështu kriteret e parashikohet në ligj dhe synon ndalimin e disponimit të lirë të kësaj pasurie dhe lërave referuar edhe jurisprudencës së GJEDNJ, masa e sekuestros preventivë dhe lërave monetare, të garantuar nga neni 41/1 i Kushtetutës dhe neni 1 Paktit Evropian për të drejtën e lirisë së shprehjes. Duke qenë se sekuestro preventivë vendoset mbi pasuri dhe depozita bankare në përfitim të disponimit të lirë të cilave ekziston rreziku për rëndimin e pasojave të veprës penale. kundërligjshme janë fituar pasuri të paluajtshme të cilat përbejnë produkt të veprës penale, nga produktive të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" dhe rezultojnë prej veprimëve të e sekuestros preventivë, ekziston dyshimi i arsyeshëm i kryerjes së veprës penale "Pastrimi i Se më sipër gjykata vlerëson se plotësohen të gjitha kushtet e parashikuara në ligj për vendosjen shtetasve ose personave juridikë të tjerë dhe për rjedhim rëndimin e pasojave të veprës penale. mëtejshme të ndryshme juridike duke sjelle kështu si pasojë që të cenohen interesat ligjore të dhe kohën e kryerjes së tyre, këto vlera monetare dhe prona mund të jenë objekt i veprimëve të blyerje të pasurive të paluajtshme. Duke patur parasysh numrin e veprimëve juridike të kryera të shkurtër menjëherë me mbërritjen e këtyre vlerave monetare, janë kryer terheqje cash dhe rrezikshmërinë e rëndimit të pasojave të veprës penale. Kjo për arsye se për një periudhë kohore Në këtë rast produktet e veprës penale janë të tilla që mbartin lidhjen e drejtpërdrejtë dhe penale ose veprimtarisë kriminale" e parashikuara nga neni 287 i K.Penal.

dhe janë fituar drejtpërdrejtë nga kryerja e veprës penale "Pastrimi i produktive të veprës veprës penale, në kuptim të nenet 36/1/b të Kodit Penal. Konkretisht, vlerat monetare rjedhimin monetare të cituara në kërkesë nuk janë të justifikuara, për rjedhim ato përbejnë produkt të 70: GIFT TO MY DEAREST FRIEND P. V zullion dyshimi i arsyeshëm se keto vlera

- 59: 4501 LEZHE
- 59: LAGJIA SKENDERBEG
- 59: P. NI VC
- 59: /
- 52A: F = BA
- 52A: 52A:BCV
- 50K: 35
- 50K: R
- 50K: ST
- 50K: /CH
- 33B: EUK3830000
- 32A: IC
- 23B: CRED
- 20: F
- COB
- AG

transfertes në mbërritje në vlerë 3 849 925 EUR si mëposhtë:  
 Nga aktet dhe provat e paraqitura nga prokurori veganerisht të dhënat identifikuese të sendit dhe veprimtari penal të kundërligjshëm.  
 një lidhjeje të posaçme, funksionale dhe jo të rastësishme (domethënë të gëndrueshme) midis mbajtja ose tjetërsimi i së cilit, përben veprën penale dhe së dyti, është e nevojshme veritetimi i pikërisht ai që përben produktin e veprës penale, shpërblimeve, të dhëna, prodhimi, përdorimi,

Ne date 20.03.2019 Prokuroria i është drejtuar Gjykates me ane te nje kerekse e cila ka kerkuar; Heqjen e sekuestros preventive te vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhe me vendimin nr 17, dt 23.01.2019, mbi llogarine bankare me nr 418156970, prane bankes BKT, ne te cilen kalon paga çdo muaj per shtetasen Sh P .

### **Pretendimet e prokurorisë:**

Prokuroria Prane Gjykates se Shkalles se Pare Lezhe, mbi bazen e materialit kallezues te referuar nga Drejtoria Vendore e Policise Lezhe, me shkresen nr. 49/ prot, date 22.01.2019 me date 22.01.2019, ka rregjistruar proedimin penal nr. 57, viti 2019 per vepren penale te "Pastrimi i produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale" te parashikuar nga neni 287 te K.Penal. Nga aktet e ketij procedimi penal rezulton se Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, bazuar në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar, nga verifikimet e kryera në databazin, për raportimet<sup>1</sup> e transaksioneve të vlerave, në emër të shtetasve P. N V i datëlindjes 01.07.1936 dhe Sh. P. P e dtl 28.08.1969 (e bija) dhe familjarët e tyre<sup>2</sup>, rezultuan transaksione në vlera të konsiderueshme dhe me anomali si më poshtë:

#### Transaksione bankare

Për periudhën korrik 2018-janar 2019, rezultuan transaksione në vlera domethënëse kryesisht në "Banka Kombëtare Tregtare" në emër të ketyre dy shtetasve.

Raportime të tjera në emër të:

Sh P

#### Kontrata noteriale

Më datë 14.09.2018, Sh P: ka porositur blerjen e tre apartamenteve dhe 3 post parkimeve në Tiranë, nga F r H me NUIS: L në vlerën e deklaruar prej 729 005 EUR, (vlera e apartamenteve 675 000 EUR dhe 54 000 EUR ajo e post-parkimeve.)

Transaksione bankare

P P

#### Transaksione bankare

Më datë 09.08.2013, llogaria në "Raiffeisen Bank" i është debituar në shumën prej 37 000 EUR.  
Më datë 11.09.2013, llogaria në "Raiffeisen Bank" i është debituar në shumën prej 10 000 EUR.

S V

#### Kontrata noteriale

Më datë 17.07.2015, ka blerë nga shoqëria " A IC" apartamentin në vlerën e deklaruar prej 30 000 EUR.  
Më datë 22.06.2018 ka blerë një apartment nga A Pi a i dtl 20.06.1982, në vlerën e deklaruar prej 5 040 000 LEK.

A V

#### Kontrata noteriale

Më datë 02.08.2013, ka nënshkruar një prokurë të posaçme te noteri V M ku emëron P shtetasin P përfaqësues të posaçëm për nënshkrimin e kontratës së shitjes së një apartamenti shtetasin P.



Më datë 10.08.2013, ka blerë një pasuri të paluajtshme në vlerën 6 000 000 LEK, te noter V M

Më datë 14.08.2018, ka blerë një apartament nga shtetasi E P i dtl 23.12.1965, në vlerën e deklaruar prej 8 750 000 LEK. Është bërë kalimi me bankë si më poshtë.

Më datë 21.08.2014, ka nënshkruar një prokurë të posaçme te noteri E K

Më datë 18.08.2016, së bashku me S V ka nënshkruar një prokurë të posaçme te noteri V M i ku është parashikuar se P V do të përfaqësojë këta dy shtetas në nënshkrimin e kontratës së pjesëtimit të pasurive të paluajtshme të përfitur me ligjin nr.7501 si dhe nga trashëgimia e P V.

Më datë 20.10.2016, ka blerë një pasuri të paluajtshme "apartament" në vlerën e deklaruar prej 34 000 EUR nga shtetasi S dhe S M të dtl 26.12.1958 dhe 30.06.1954.

Më datë 14.08.2018, ka blerë 3 një apartament në vlerën e deklaruar 70 000 EUR, nga shtetasi E P , i dtl 23.12.1965.

Më datë 14.09.2018, ka blerë nga shtetasi D dhe K M të dtl 20.04.1965 dhe 13.02.1968, një apartament në Shëngjin në vlerën e deklaruar prej 80 000 EUR.

*Sa më sipër, bazuar në nenin 11/ë të ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008, i ndryshuar kemi kërkuar informacion në "Banka Kombëtare Tregtare" lidhur me këta shtetas, nga ku ka rezultuar se:*

Për periudhën 23.07.2018 e në vijim llogaria e S : P në "Banka Kombëtare Tregtare" është kredituar nga 10 transferta të dërguara nga Zvicra, nga një shtetas suedez me gjeneralitete S A L në vlerën totale prej 1 419 626 EUR përshkruar si më poshtë:

Për periudhën 23.07.2018-29.08.2018 kanë mbërritur 5 transferta në vlerën totale prej 1 184 838 EUR ku vetëm transferta e parë përmbante qëllimin e dërgimit, atë të deklaruar si "shpenzime familjare" në vlerën prej 9 978 EUR, ndërkohë të tjerat nuk përmbanin asnjë element për përshkrimin e qëllimit të përdorimit të shumave të dërguara. Në BKT kjo shtetase ka bërë disa deklarata kontradiktore si:

Fondet në të vërtetë janë dhuruar nga shtetasi suedez me vendbanim në Zvicër, për shkak të marrëdhënieve të afërta të motrës së saj, A V , shtetase suedeze, me shtetasin suedez S A I i cili është pronar i kompanisë " " , (me aktivitet tregtimin me shumicë dhe pakicë të pjesëve të këmbimit dhe aksesoreve të makinerive dhe mjeteve motorike) në të cilën shtetasja A V , punon si menaxhere, me qëllimin e përdorimit të tyre për blerjen e 3 apartamenteve nga dy motrat dhe vëllai i tyre shtetasi S V

Fondet në fakt destinohen si dhuratë për motrën e saj A V , e cila do t'i investojë në blerjen e pasurive të paluajtshme në Shëngjin.

Konkretisht në këtë periudhë evidentohet se:

Më datë 30.07.2018, llogaria i është kredituar në shumën 9 978 EUR nga transferta e shtetasi suedez S A L me përshkrim "shpenzime spitalore". Më datë 31.07.2018 ka tërhequr në cash 9 975 EUR, ndërkohë lidhur me përdorimin e pjesës tjetër të fondeve të transferuara rezulton që:

Më date 01.08.2018, llogaria i është kredituar nga transferta tjetër e shtetasi suedez S A L në vlerën prej 24 950 EUR. Nga kjo shumë vlera prej 20 000 EUR ka kaluar në favor të noterit, V M pranë "Tirana Bank" dhe më vonë më datë 02.08.2018 ka tërhequr 40 000 EUR.

Më datë 15.08.2018 & 29.08.2018, llogaria i është kredituar edhe nga dy transferta të tjera, përkatësisht në vlerat 49 925 EUR & 29 945 EUR. Më datë 03.09.2018, këto fonde i ka kaluar në



favor të noterit V M

Duhet theksuar se për të dy pagesat në favor të noterit V M, S P P ka deklaruar verbalisht se qëllimi i tyre do të ishte për "Blerje Apartamenti për A V" dhe "Likuidim, blerje pasurie e paluajtshme".

Më datë 30.08.2018, llogaria e saj është kredituar në shumën prej 1 069 925 EUR, e cila ka pasur vlerën më të konsiderueshme në raport me transfertat e mëparshme, përkatësisht pa asnjë detaj në rubrikën e "përshkrimi i transaksionit", prej të cilave 469 638 EUR janë vendosur në depozitë, 79 800 janë transferuar në favor të noterit V M dhe 600 000 EUR janë transferuar në favor të F H -PF.

Për periudhën nëntor 2018-janar 2019, llogaria e saj është kredituar në shumën totale prej 234 788 EUR nën përshkrimet: "dhuratë për Krishtlindje, kompensim page, veshmbathje dimri, aksesori kuzhine" (49 900 EUR), "rikonstruktim dhe ndihmë financiare" (94 875 EUR) "mbulimin e disa shpenzimeve spitalore për kurimin e të atit të saj" (4 983 EUR), "blerje pajisjesh shtëpiake" (84 925 EUR). Nga kjo shumë totale, 94 900 janë vendosur në depozitë, 4 983 EUR janë tërhequr.

Më datë 16.01.2019, P V ka çelur një llogari pranë BKT, arsyen e hapjes së cilës e ka deklaruar për qëllimin e përfitimit të disa fondeve nga shtetasi suedes S A L, të cilat do të përdoren për mbulimin e disa shpenzimeve spitalore të P V i dekalron se vuan nga një sëmundje veshkash.

Më datë 17.01.2018, ka mbërritur një transfertë nga Zvicra, në vlerë tepër të konsiderueshme 3 849 925 EUR. Urdhëruesi i kësaj transferte është S A L dhe përsa i përket qëllimit të saj, nga detajet e pagesës kuptojme se bëhet fjalë për një dhuratë "Gift to my dearest friend P V". Banka urdhëruese e transfertës është "BANQUE CANTONALE DU VALAIS" në Zvicër dhe banka korespondente është COMMERZBANK AG në Gjermani.

Gjykata e Shkalles së Parë Lezhe me vendimin gjyqësor nr 17, dt 23.01.2019, ka vendosur masen e sekeustros preventive mbi të gjitha pasuritë dhe llogaritë bankare të shtetasve P V dhe Sh P


Mbi bazën e këtij vendimi është vendosur sekuestro preventive dhe mbi llogarinë bankare (llogarinë e pages) me nr 418156970, të shtetasës S F, që ajo merr si punonjese pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshem të Kudjesit Shendetesor Lezhe.

**Shtetësja S P ka paraqitur një kerkese në Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkalles së Parë L, ku kërkon heqjen e sekuestrës preventive dhe zhbllokimin e llogarisë bankare me nr 418156970, pranë bankës BKT, në të cilën kalon paga çdo muaj e shtetasës Sh P si e punësuar pranë DRSDKSH Lezhe.**

**Në keto kushte, meqenese sekuestro e vendosur mbi llogarinë bankare me nr 418156970 pranë bankës BKT, cenon të ardhurat e shtetasës Shqipe Palaj, kjo sekuestro duhet të hiqet.**

#### **Arsyetimi ligjor:**

Siç ka rezultuar nga rrethanat e faktit, Prokuroria e rrethit gjyqësor Lezhe, ka regjistruar procedimin penal Nr. 57 të vitit 2019 për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale" ndaj shtetasve P V dhe Sh P. Nga veprimet hetimore të kryera në kuadër të këtij procedimi ka rezultuar se Drejtorja e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, bazuar në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar, nga verifikimet e kryera në databazin, për raportimet e transaksioneve të vlerave, në emër të shtetasve P N V dhe Sh P dhe familjarët e tyre, kanë rezultuar transaksione në vlera të konsiderueshme dhe me



anomali si më poshtë:

Transaksione bankare; Për periudhën korrik 2018 janar 2019, rezultuan transaksione në vlera domethënëse kryesisht në "Banka Kombëtare Tregtare" në emër të ketyre dy shtetasve.

Raportime të tjera në emër të: S P ; Kontrata noteriale, Në datë 14.09.2018, S P ka porositur blerjen e tre apartamenteve dhe 3 post parkimeve në Tiranë, nga F H me NUIS: L ; në vlerën e deklaruar prej 729 005 EUR, (vlera e apartamenteve 675 000 EUR dhe 54 000 EUR ajo e post-parkimeve).

Transaksione bankare; P P ; Në datë 09.08.2013, llogaria në "Raiffeisen Bank" i është debituar në shumën prej 37 000 EUR. Në datë 11.09.2013, llogaria në "Raiffeisen Bank" i është debituar në shumën prej 10 000 EUR.

S V ; Kontrata noteriale; Në datë 17.07.2015, ka blerë nga shoqëria "EURO ADRIATIC" apartamentin në vlerën e deklaruar prej 30 000 EUR. Në datë 22.06.2018 ka blerë një apartament nga A P , në vlerën e deklaruar prej 5 040 000 LEK.

A V ; Kontrata noteriale; Në datë 02.08.2013, ka nënshkruar një prokurë të posaçme ne Zyren e Noterise Lezhe te noter V M , ku emëron përfaqësues të posaçëm për nënshkrimin e kontratës së shitjes së një apartamenti, shtetasin P P .

Në datë 10.08.2013, ka blerë një pasuri të paluajtshme në vlerën 6 000 000 LEK, te noter V

M: . Në datë 14.08.2018, ka blerë një apartament nga shtetasi E P i dtl 23.12.1965, në vlerën e deklaruar prej 8 750 000 LEK. Në datë 18.08.2016, së bashku me S V ka nënshkruar një prokurë të posaçme te noter V M: ku është parashikuar se P V do të përfaqësojë këta dy shtetas në nënshkrimin e kontratës së pjesëtimit të pasurive të paluajtshme

të përfituar me ligjin nr.7501 si dhe nga trashëgimia e te ndjeres P V Në datë 20.10.2016, ka blerë një pasuri të paluajtshme "apartament" në vlerën e deklaruar prej 34 000 EUR nga shtetasit S dhe S M .

Në datë 14.08.2018, ka blerë 4 një apartament në vlerën e deklaruar 70 000 EUR, nga shtetasi E P . Në datë 14.09.2018, ka blerë nga shtetasit D dhe K M një apartament në Shëngjin në vlerën e deklaruar prej 80 000 EUR.

Ka rezultuar se, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhe me vendimin Nr. 17, dt. 23.01.2019 ka vendosur: Vendosjen e sekuestros preventive mbi; Llogarite, transaksionet bankare dhe çdo depozite ne Bankat e nivelit te dyte, Banka Kombetare Tregatre, në emër dhe për llogari të shtetasve; P V i biri i N: dhe D , i datëlindjes me ID nr.

D , lindur ne fshatin Kalivaç, banues ne fshatin Gjader, Njesia Administrative Balldre, Bashkia Lezhe dhe Sh P , e bija e P dhe P , e datelindjes 28.08.1969, me ID nr.G

, lindur ne fshatin Gjader dhe banues ne Lezhe.....

Kërkuesja Sh P ka kërkuar heqjen e kësaj mase vetëm përsa i takon vënies sekuestro preventive mbi llogarinë e saj bankare ne lidhje me te ardhurat qe perfiton nga paga per punen e kryer prane Drejtorise Rajonale te Fondit te Sigurimit te Detyrueshem te Kujdesit Shendetesor Lezhe duke pretenduar se i cenohen ne menyre te drejteperdrejte te ardhurat kryesore te jeteses se saj.

Gjykata vëren se, kerkesa e prokurorise per heqjen e sekuestros preventive mbi llogarinë bankare ne lidhje me te ardhurat qe perfiton nga paga per punen e kryer prane Drejtorise Rajonale te Fondit te Sigurimit te Detyrueshem te Kujdesit Shendetesor Lezhe shtetasja Shqipe Palaj është e bazuar në prova e në ligj.

Masat e sigurimit pasuror parashikohen në një kre të veçantë të K.Pr.Penale, Kreu XI, nenet 270-276 të tij, i ndarë në dy Seksione, Seksioni I mbi sekuestron konservative dhe Seksioni II mbi



sekuestron preventive, masë e cila është vendosur ndaj shtetases Sh P në çështjen objekt shqyrtimi.

Pikërisht për këtë shkak, duke qenë se në rastin konkret, me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhe, ndaj shtetases Sh P është vendosur sekuestroja preventive sipas nenit 274 të këtij Kodi, nder te tjera edhe mbi llogarinë bankare ne lidhje me te ardhurat qe perfiton nga paga per punen e kryer prane Drejtorise Rajonale te Fondit te Sigurimit te Detyrueshem te Kujdesit Shendetesor Lezhe dhe ne kushtet kur kane ndryshuar kushtet e zbatimit te mases, mund të hiqet ajo bazuar në nenin 274/3 të K.Pr.Penale.

**Lidhur me pretendimet e ngritura në gjykim për sekuestrimin preventiv të llogarise bankare të shtetases S P , me burim të ardhurash nga institucionet shtetërore ku ajo ushtron funksionet e saj, në seancë gjyqësore, prokurori kerkoj zhbllokimin e llogarise rrjedhëse të kësaj shtetasje me burim të ardhurash nga Institucionet Shtetërore ku ushtron veprimtarinë e saj duke pretenduar se; meqenese sekuestro e vendosur mbi llogarine bankare me nr . prane bankes BKT, cenon te ardhurat e shtetases S P , kjo sekuestro duhet te hiqet.**

Rastet se kur e hiqet kjo masë, janë të përcaktuar në nenin 274/3 të K.Pr.Penale. Përkatësisht; *Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata, me kërkesën e prokurorit ose të të interesuarit, e heq sekuestron.* Çka do të thotë se, gjykata në këto raste mund të disponojë heqjen e masës së sigurimit, bazuar në nenin 274/3 të K.Pr.Penale.

Gjykata vëren se, pretendimi i organit të akuzës se meqenese sekuestro e vendosur mbi llogarine bankare me nr . prane bankes BKT, cenon te ardhurat e shtetases Sh P , çmon se kjo sekuestro duhet te hiqet, bazuar ne nenin 274/3 të K.Pr.Penale, pasi mund të kërkohet për sa kohë që cenohen ne menyre te drejteperdrejte te ardhurat kryesore te jeteses se shtetases Shqipe Palaj.

### PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar në nenin 274 të Kodit të Proçedurës Penale, nenin 1 Prot I të KEDNJ,

### VENDOSI

1. Pranimin e kerkeses.
2. Heqjen e sekuestron preventive te vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhe me vendimin nr 17, dt 23.01.2019, mbi llogarine bankare me nr . , prane bankes BKT, ne te cilen kalon paga çdo muaj per shtetasen Sh P
3. Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykaten e Apelit Shkoder, nga secili person qe ka interes brenda 10 (dhjete) diteve nga dhenia e vendimit ose nga dita qe i interesuari ka marre dijeni per heqjen e sekuestron.

U shpall ne Lezhe, sot me 21.03.2019.

SEKRETARE

Diella Ndoci

